

POETIKA

revistë e poezisë dhe e kulturës poetike - viti i pestë i botimit - numri 13 - dimër, 2008 / 2009

Milena Selimi, Arian Leka, Rudolf Marku, Ramadan Musliu
Gjekë Marinaj, Valbona Bozgo, Eliana Alien, Viola Isufaj,
Ilir Paja, Alisa Velaj, Norel Zaimi, Migena Gjoka - Metohu,
Arundat Subramaniami, Arian Kallço,
Casimiro de Brito, Entela Safeti-Kasi, Paolo Ruffilli,
Iskandar Habache, Anton Papeleka, Goy Chembelland, Balil Gjini,
Victor Segalen, Romeo Çollaku, Sibila Petlevski, Senad Guraziu,
Dalan Luzaj, Mira Meksi, Milan Rakovac, Zef Zorba, Eqrem Basha...



Shpirtësia poetike e truallit ekzistencial

rreth librit poetik “Lutje në ditën e tetë të javës” të Gjekë Marinajt

Ramadan Musliu

Oksimoroni poetik

Gjekë Marinaj iu imponua opinionit letrar me librin poetik “Lutje në ditën e tetë të javës”. Që në titull ndeshim figurën e oksimoronit: “dita e tetë e javës”, që në të vërtetë është një antitezë thelbësore e thellësisë, sepse pajton dy të kundërtat, dy negacionet ekstreme. Kjo figurë do të kishte peshë, po të merrej vetëm si një figurë që është dhënë vetëm në titull, sikur të mos shtrihej edhe si koncept, edhe si një segment problematizues e tematizues nëpër gjithë poezinë. Që nga titulli e deri te vjershat e veçanta ndeshim prirjen e poetit që të merret me tepricat e jetës dhe margjinat e ekzistencës, me ato që kanë dalë jashtë rregullit, jashtë normës, me atë që del edhe jashtë logjikës së standardizuar. Në pajtim me këtë koncept vijjnë edhe idetë e radhës, të cilat kulmojnë me figurën e purgatorit, një zonë neutrale, që rri midis dy ekstremeve dhe nuk shkrihet në asnjërën. Pra, në theks është margjina, ajo që del jashtë qendrës, por që është përcaktuese e thelbësore. Pra në spikamë është zona e ndërmjetme, ajo që autori do ta quajë si “kalim i sekondave në minuta” apo “jetë brenda membranës së fluskave”, zgripi i ekzistencë, faza e pahetueshme kur ndodh shpërnderimi thelbësor. Madje, duke u thelluar në kapjen e këtyre momenteve, autori arrin të ndërtojë një qark idesh që pastaj ato të shtrihen si një koncept që del nga thelbi i të menduarit dhe i të ndjerit të jetës, duke e shquar edhe kromatiken e perceptimit poetik.

Konceptualiteti poetik

Poeti Gjekë Marinaj, në dallim nga poetët e tjerë pararendës, por edhe nga ata të gjeneratës së tij, synon në mënyrë të qëllimshme që të radikalizojë poezinë si në tematikë, po ashtu edhe në gjuhë. Kjo përpjekje rezulton në një profilizimin të vetë esencës së shprehjes. Tematika e kësaj poezie është e identifikueshme: jeta e përditshme, tema e ambientit, si në kuptimin e ngushtë, siç është ai ekzistencial, i përditshmi, po ashtu edhe në kuptimin e gjerë, ambienti si hapësirë që merr përmasa kozmike apo,

edhe në të kundërtën, si hapësira mikrokozmiqe, që nënkupton hapësirat e brendshme shpirtërore - metafizike. Gjatë leximit të kësaj poezie, në veçanti, në rastet kur autori qëllimisht merret me ide të caktuara dhe të vëna në sistem, na bëhet se kemi të bëjmë me një traktat filozofik të shkruar në vargje. Mbase në këtë pikë na duket se ka diçka empedokliane apo edhe parmenidiane. Edhe pse në pamje të parë fitohet bindja se autori më shumë mendon se sa ndien, e vërteta më e qëndrueshme është se ai mendon përmes koncepteve, për aq sa fitohet mbresa se ky konceptualitet poetik në fakt është një amalgamë e njohjes, domethënë e të menduarit me ndjeshmëri thelbësore, ekzistenciale dhe se çdo thellim në këtë poezi duket si një zhytje në plazmën e ndjeshmërisë së shkrirë në koncepte. Prandaj si moto e gjithë kësaj poezie do të ishin vargjet: “Shpirt i zbardhur gjer në shpirt / çdo fjalë / lëshon tinguj marramendës / nga kontakti i filozofisë me ndjenjën” (“Poezia”, faqe 71).

Amplituda tematike

Poezia e Gjekë Marinajt dallohet edhe për arsenalin e pasur të figuracionit poetik, po aq edhe për një gjerësi tematike. Kur thuhet “gjerësi tematike” në radhë të parë merret parasysh sfera e ideve, domethënë baza ideore e poezisë, sepse brenda një njësie poetike arrin të gërshetohen një varg idesh, të cilat ndikojnë në disperzionin e temës bazë, por që ia mundësojnë fundamentin ideor të vetë poezisë, domethënë ia garantojnë një kohezion të brendshëm të objektit rreth të cilit përqendrohet refleksioni. Prandaj për këtë poezi mund të themi së është tejet komplekse si shprehje, si qark i ideve, sepse kemi të bëjmë me një sistem idesh, si tematikë, sepse optikat me të cilat i vështron temat dhe problemet e jetës është e perspektivave të ndryshme, por që si perceptim arrin të fokusohet në një optikë individuale. Në këtë poezi kemi disa perspektiva të vrojtimit: intriospektionin, që është thellim në vetvete, sikurse që ndodh me idenë për një “udhëtim për në qendër të vetes”, siç kemi edhe retrospektionin, që është kthim prapa, shfrytëzimi i përvojave të përparshme, qofshin ato nga dija, miti, legjenda, historia, që herë vështrohen në një distancë më të largët e herë në një distancë më të shkurtër. Po afiniteti i tij më i dallueshëm është ai për introspektion, që e nxjerr në shesh prirjen e tij meditative, aftësinë për të kërkuar në vetvete, kërkim që shpie nga sferat njohëse. Për autorin nuk janë të huaja as proceset fizike e as ato fiziologjike, si aspekte tematizuese të përditshmërisë, e aq më pak ato metafizike, që janë rezultat i një shkrirjeje e të menduarit me emocionet e thella. Në poezinë e Gjekë Marinajt sikur kemi, po të huazojmë një metaforë bodleriane, shëtitje “nëpër pyllin e simboleve”, ngase autori përqendrohet në aftësinë për të kërkuar në vetvete, kërkim që shpie nga sferat njohëse, ngase autori në çdo gjë sheh një kuptim të thellë, një domethënie të fshehtë që vjen nga një burimësi hyjnore.

Nuk është e rastit pse në të folurit e tij poetik kemi fragmente scientiste, nocione që tregojnë nivelin e lartë të abstraksionit, por që të gjitha këto nuk mbesin në nivel të një refleksioni pa objekt, për shkak se i gjithë arsenalin i përdorur ka të vetmin qëllim: funksionalizimin e kontekstit poetik, pasurimin e gamës së ideve, emocioneve dhe të kromatikes.

Lidhja me tokën

Poezia e Gjekë Marinajt vërtetë përmban një minierë të vërtetë figurash, idesh, ngjyrash, sikurse edhe nocionesh, konceptesh, pastaj një rreth të gjerë refleksioni dhe një predispozicion të lindur për meditim. Mirëpo kjo poezi në asnjë rast nuk është poezi e efemeriteteve, e gjendjeve trasnecedentale që zakonisht përfundojnë në një estetizëm ekstrem, ku funksioni i fjalës është vetëm të rikrijojë gjendje estetizante, por jo që ato gjendje t'i transmetojë tek recipienti, sepse në raste të tilla ekziston gjithnjë një barrierë komunikimi. Poezia e Gjekë Marinajt, përkundrazi, ngaqë si qëllim të vetin primar ka komunikimin, transmetimin e një shqetësimi të thellë, i cili nuk është diçka solipsiste, diçka e personalizuar, por një ndjenjë, ide, imazh, përfytyrim i personalizuar deri në atë masë sa të shprehë shpirtin e vetë poetit, thellësinë e subjektivitetit të tij, por gjithnjë me pretendim që të kapë atë universalen, atë që mund të quhet si shqetësim i të gjithëve, që jemi mësuar ta quajmë si vlerë universale. Në këtë kontekst duhet vështruar si poezitë, që motivet initiale i vjelin nga sferat e dijes dhe shkencës, po kaq edhe ato që janë rezultat i një shqetësimi permanent të poetit të preokupuar me ambientin e vet ekzistencial, me ambientin prej nga bart rrënjët e veta, me kohë-hapësirën aktuale dhe universale. Në këtë libër një segment i veçantë tematik është ai i dheut, i truallit të lindjes, i ambientit nga bart origjinën poeti dhe njeriu përgjithësisht. Ajo prirja familjarizuese e poetit me gjërat që i poetizon, prirja që ta intimizojë botën, brenda poezisë së tij arrin të nxjerrë në sipërfaqe lidhjet e fuqishme shpirtërore që dalin nga raportet e thella që subjekti krijon me rrethin ekzistencial. Prandaj edhe në poezitë që për objekt këngëtimi kanë qoftë vendlindjen me njerëzit e vet (nëna, fqinjët, njerëzit e atij ambienti, siç janë, fjala vjen, "këngëtarja e bjeshkëve"), qoftë peizazhet e atdheut, duke filluar nga Shkodra deri në Klinë, apo reprezentët aktualë dhe historikë të atij ambienti (Nënë Tereza, Skënderbeu, Fishta, Migjeni, apo miqtë e poetit si P. Buzhala, D. Luzaj etj.) apo atdheu në kuptimin e gjerë, (Shqipëria dhe Kosova) gjithnjë në spikamë vihet dimensionin e brendshëm, aspekti emocional dhe përfytyrimi idealizues.

Këto poezi, që kanë inspirime konkrete, dallohen për një spontanitet dhe një ndjeshmëri më të fuqishme. Mbase mund t'i mungojë ai bazamenti dallues refleksiv, porse atë e zëvendësojnë me fundamentin emocional, bazën e plazmuar emocionale nëpër të cilën frekuentojnë imazhet dhe pamjet që lidhen qoftë me personalitetet apo toponiminë e një vendi. Te këto poezi Gjekë Marinaj bëhet më konkret, më i prekshëm, më plazmues në poezi, më i qartë sa i përket ravijësimit të ideve, por edhe më i formësuar në figurën poetike. Janë këto poezi të mallit, poezi të një ndjenje të hollë, të një emocioni vibrues. Megjithatë, as këtu nuk tretet ai perceptimi dhe vrojtimi prej mendimtari, vetëm se kësaj radhe krijohet një mbresë se mendimi derdhet si rëra në klepsidër, duke u shndërruar në një plazmim emocional: "Më e pazëshme se vetë varfëria / Shqeu lëkurën e trupit të saj / Për të arnuar me të plagët e të tjerëve. / Ajo dha gjithçka / Kur s'kishte asgjë për të dhënë" ("Gonxhe Bojaxhiu", faqe 94).

Në vend të përmbylljes

Poezia e Gjekë Marinajt, siç kemi thënë diku në fillim, është në shenjë të përpjekjes për ta radikalizuar poezinë shqipe. Pse radikalizim? Arseja e vetme është se autori nuk pajtohet me modelet e njohura poetike që ofron qoftë tradita apo edhe bashkëkohësit tij, që tashmë janë shndërruar në epigone të modeleve të njohura dhe të deplasuar poetike. Autori, në dallim nga modelet e këngëtimit baladesk të poezisë *agolliane*, që rri në fqinjësi të ngushtë me atë orale, apo, përkundër modelit kolokuial të poezisë *kadareane*, si dy modele me të cilat sot, jo me shumë të drejtë, krahasohen të arriturat poetike në Shqipëri, ai është larg edhe njëherë, edhe tjetrës: është një model më vete, si një kontrapunkt me to. Poezia e Gjekë Marinajt është e drejtpërdrejtë në frymëzim, jetësore si problematizim, konceptuale dhe me një fundament të fortë reflektiv, është lirike dhe e ndjeshme në emocion, e kapshme dhe abstrakte njëkohësisht. Ajo pajton skajshmëritë duke gjetur balancim të ideve të kundërta, imazheve kontrastive, kuptimeve antitetike. Ajo, para së gjithash, është vetvetja: një realizim i individualizuar, poezi që e ka identitetin e vet tematiko-motiv, stilistiko-figurativ të perceptimit dhe të kromatikës, çfarë duhet ta cilësojmë një poezi të klasit.